



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 107 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me nenin 17 pika 13 të Rregullores së Punës, Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datën: 20.11.2023, shpallë këtë:

K O N K U R S
PËR EKSPERTË TË JASHTËM PROFESIONAL TË PROKURIMIT DHE
EKSPERTË TË JASHTËM TEKNIK

Përmes së cilit i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 25 pika 3 të Rregullores Nr.01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Autoriteteve Kontraktuese dhe operatorëve ekonomik do të përpilojë dhe mbajë regjistrin e **Ekspertëve Profesional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, të kualifikuar për shqyrtimin e ankesave të Operatorëve Ekonomik, të cilët do të angazhohen (ad hoc) sipas rasteve për shqyrtimin e ankesave dhe zbatimit të aktiviteteve të Prokurimit, konform kushteve të përcaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që brenda afatit të caktuar në shpallje të paraqiten me dokumentacionin përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Numri i Ekspertëve Profesional të Prokurimit të cilët do të përzgjidhen për të qenë pjesë e listës së Ekspertëve Profesional të Prokurimit do të jetë pesëmbëdhjetë (15).

Kandidatët të cilët pranojnë të jenë pjesë e listës së Ekspertëve Profesional të Prokurimit të Jashtëm dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik në Organin Shqyrtues të Prokurimit, bazuar në nenin 5 pika 1.8 të Ligjit nr. 08/L-108 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, janë të obliguar sipas këtij ligji që të bëjnë deklarin e pasurisë.

Inkurajohen Ekspertët Profesional të Prokurimit dhe Ekspertët Teknik të Prokurimit, të cilët janë aktualisht pjesë e listës së ekspertëve të përzgjedhur nga OSHP-ja, nëse dëshirojnë të jenë pjesë e listës së Ekspertëve Profesional dhe Teknik të Jashtëm të OSHP-së, të aplikojnë përsëri, për arsye se kontratat të cilat i kanë të lidhura me OSHP-në, pas përpilimit të listës së re, më nuk do të jenë valide.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspertë Profesional të Prokurimit janë:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
2. Të ketë zotësi të plot të veprimit
3. Diplomën universitare nga Fakulteti Juridik ose Ekonomik
4. Të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune pas diplomimit
5. E preferushme certifikata e prokurimit e lëshuar nga IKAP
6. Të ketë njohuri të mira të Ligjit të Prokurimit Publik
6. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkëngjisin aplikacionit këto dokumente :

- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
- Vërtetimin mbi përvojën e punës pas diplomimit;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
- Certifikatën nga evidence penale, e lëshuar nga gjykata;
- Vërtetimin që nuk jeni nën hetime nga Policia e Kosovës;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspert të Jashtëm Teknik janë:

1. Të kenë të kryer Fakultetin e drejtimeve si në vijim:

- Inxhinier të Ndërtimtarisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të drejtimit Hidro (3 ekspert/e);
- Inxhinier të drejtimit Konstrukione (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Arkitekturës (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Makinerisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Bujqësisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Veterinarisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të drejtimit Agrobiznes (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Gjeodezisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Xehtarisë (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Elektroteknikës (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Elektro (Energjisë) (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Komunikacionit (3 ekspert/e);
- Inxhinier të Teknologjisë Informative (3 ekspert/e);
- Kimist/e (3 ekspert/e);
- Farmacist/e (3 ekspert/e);
- Biolog/e (3 ekspert/e);
- Ekspert/e i/e tekstilit (Dizajner/e etj (3 ekspert/e);
- Teknolog/e të ushqimit (3 ekspert/e);
- Epidemiolog/e (3 ekspert/e);
- Teknik/e i/e radiologjisë (3 ekspert/e).

2. Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit
3. E dëshirueshme të kenë njohuri rreth Ligjit të Prokurimit Publik
4. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkëngjisnin aplikacionit këto dokumente :

- Certifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
- Vërtetimin mbi përvojën e punës pas diplomimit;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
- Certifikatën nga evidence penale, e lëshuar nga gjykata;
- Vërtetimin që nuk jeni nën hetime nga Policia e Kosovës;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në kopje fizike në Organin Shqyrtues të Prokurimit / Zyra e Personelit (Adresa : Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës së Lubjanës, Kati i V-të, Prishtinë).

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata shtesë mund të kontaktoni me **Zyrën e Personelit** në numrin e telefonit: **038/212-360 prej orës 08:00 – 16:00.**

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në faqen e OSHP-së, prej datës: 20.11.2023 deri më datën: 04.12.2023 në ora 16:00.

Pas përfundimit të përpilimit të listës së **Ekspertëve Profesional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, Organi Shqyrtues i Prokurimit, do të informojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për **"Ekspert Profesional të Prokurimit në OSHP dhe për Ekspert të Jashtëm Teknik"**.

Prishtinë, 20.11.2023